



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja nr. 22
Prishtinë, më 25.03.2009 ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës
Salla nr. N- 203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Agim Veliu, Drita Kadriu, Mark Krasniqi, Memli Krasniqi Adem Hajdaraj, Heset Cakolli, Gani Buçinca dhe Dragan Dimiq .
Munguan: Enis Kervan, Donika Kadaj-Bujupi dhe Fatmire Berisha.

Në mbledhje morri pjesë, **Rektorë i Universitetit të Prishtinës, Enver Hasani.**

Mungoi: Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z. Enver Hoxhaj.

Në mbledhje prezantuan: **Kujtim Shala**- përfaqësues i degës së Stomatologjisë në FM në Prishtinë, **Luan Jaha** - përfaqësuesi i magjistrave të shkencave të Fakultetit të Mjekësisë dhe **Bahri Hyseni** - kryetar i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e udhëhoqi **Agim Veliu**, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

- 1. Shqyrtimi i kërkesës së stafit Akademik të Degës së Stomatologjisë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë për vazhdimin e studimeve të Doktoraturës.**
- 2. Shqyrtimi i kërkesës të magjistrave të shkencës mjekësore të magjistruar në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë për vazhdimin e studimeve të Doktoraturës.**

Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

Agim Veliu- kryesues, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes. Ai tha se për këtë mbledhje janë të ftuar Enver Hoxhaj - ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Enver Hasani, rektori i UP-së. Kryesuesi, konstatoi se Ministri i Arsimit mungesën e tij e ka arsyetuar se do të udhëtojë jashtë vendit. Mirëpo, ministri ka premtuar se pjesëmarrjen e tij për këtë takim do ta zëvendësoi zëvendës ministri por i njëjti nuk ka marrë pjesë në mbledhje. Kryesuesi - tha se do të debatohet lidhur me dy pikat e rendit të ditës dhe në bazë të diskutimeve të cilat do të dalin nga ky takim, pastaj ne si komision do të nxjerrim Rekomandim.

Kryesuesi fjalën ua dha përfaqësuesve të kërkesave të prezantuara dhe njëkohësisht do ti dëgjojmë Rektorin e UP-së Enver Hasani dhe kryetarin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi Bahri Hyseni.

Kujtim Shala - përfaqësues i degës së Stomatologjisë në FM, prezantoi para Komisionit problemet të cilat paraqesin komplekse për krijimin e kushteve të nevojshme statusore-ligjore që magjistrat e shkencave të mjekësisë të përfundojnë studimet e doktoratës. Ai tha se zbatimi i Ligjit mbi Arsimin e Lartë dhe Statusit të UP të miratuar nga Parlamenti ka paraqitur probleme, ku në konkursin e rregullt për staf akademik të vitit 2007 në FM eliminohen 138 kandidatë në rizgjedhje me arsye të gradave shkencore. Ai parasheh dy çështje për zgjedhjen e kësaj shtate. E para është se duhet të ndryshohet Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Statusit të UP-së. Si zgjedhje të dytë parasheh të formohet Universiteti biomjekësor me të cilin do të rregullohen çështjet në mënyrë ligjore dhe institucionale. Ai, problemin e magjistrave dhe doktorëve e shtroi në tri raste. Magjistratura hap mundësinë që doktorata duhet të fitohet në bazë të punimeve shkencore dhe hulumtuese të kandidatëve që janë aktivë në shkencë dhe kanë punime të publikuara, ndërsa qasja në këtë proces po pengohet. Çështje tjetër me rëndësi është se bëhen manipulime me numër të kandidatëve. Në grupin e parë janë magjistrat të cilët duhet të bazohen në sistemin linear dhe atyre duhet ti lejohet qasja në doktoratë. Në grupin e dytë janë kandidatët të cilët kanë regjistruar studimet e doktoratës në vitin 2005 e i cili program nuk ka pas kapacitet të organizojë seleksionimin në bazë të kriterëve të përcaktuara. Ndërsa në grupin e tretë janë selektuar kandidatë nga konkursi i fundit të datës 19 janar 2009, për studime të doktoratës në UP. Për këtë arsye janë paraqitur konfuzione sepse në grupin e tretë janë paraqitur kandidatët e të dy grupeve të para. Në fund theksoi se për të dalë nga kjo situatë problematike duhet të krijohen mundësit statusore që të ndryshohet Ligji dhe Statuti i UP-së në mënyrë që këta kandidatë të mbesin në Universitet.

Luan Jaha –përfaqësues i grupit të shkencave mjekësore, theksoi se në vitin 2005 Senati i UP-së ka sjellë vendim i cili ka ndaluar aplikacionet për tema të doktoraturës, me arsyetim se do të fillohet të punohet në bazë të sistemit të ri. Mirëpo sistemi me të cilin ne kemi magjistruar në vitin 2005 akoma zbatohet në të gjitha shtetet e rajonit.

Ai shtoi se asnjë vend i sistemit të vjetër nuk i ka penguar të jenë pjesë e marrëveshjes së Bolonjës, mirëpo këtë e ka kundërshtuar rektori i UP-së Hasani, duke shtuar se ai e respekton Ligjin mbi Arsimin e Lartë dhe nuk heq dorë nga qëndrimi i tij.

Ai tha se problemi rezulton për shkak se këto studime nuk kanë filluar asnjëherë. Që nga viti 2005 e deri me 2008, numri i magjistrave të shkencave të mjekësisë, specialistë dhe subspecialist të fushave të ndryshme të mjekësisë është rritur në 200, të cilëve tranzicioni i paramenduar keq ua ka marrë të drejtën që të doktorojnë.

UP-ja në vitin 2005 ka hapur një konkurs për regjistrim në vitin e parë ku janë regjistruar të gjithë ata që nuk ishin magjistra dhe konkursi për vitin e tretë ku janë regjistruar magjistrat e mjekësisë në bazë të sistemit të Bolonjës.

Komisioni ka bërë vlerësimin në përzgjedhje në bazë të kriterëve; nota mesatare, njohja e gjuhës angleze dhe punimet shkencore. Magjistrat e shkencave të mjekësisë, duke pasur parasysh se ky problem po bëhet kompleks, në dhjetor të vitit 2008 iu kanë drejtuar rektorit Enver Hasni për një takim për zgjedhjen e çështjes së doktoratës.

Ai shtoi se në vend që rektori të bëjë zgjedhje, ai bën shkeljen e konkursit dhe eliminon 300 kandidatë pa hapur fare dosjet e tyre, duke mos bërë përzgjedhjen në bazë të kriterëve edhe përkundër faktit se në konkursin publik askund nuk figuron se të drejtë konkurrimi kanë vetëm stafi i rregullt i Universitetit. Komisioni i veçantë i formuar pranë Fakultetit të Mjekësisë e bënë publike listën e 135 kandidatëve.

Grupi, njëkohësisht iu është drejtuar edhe Senatit të UP-së me shkresë për vazhdim të doktoratave sipas sistemit të vjetër ndërsa ende nuk ka marrë përgjigje.

Rektori Enver Hasani theksoi se kërkesat e parashtruesve janë në kundërshtim me Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit të Prishtinës dhe Kartën e Bolonjës. Në bazë të konkursit të vitit 2005, kërkesat e magjistrave që të vazhdojnë me sistemin e vjetër të doktoratave i vlerësoi të papranueshme se kjo bie në kundërshtim me Asociacionin e Universitetit Evropian sepse regjistrimi i 435 kandidatëve është trefishi i studentëve në bachelor në Fakultetin e Mjekësisë.

Ai tha, se e drejta e doktoratës nuk mund të jetë e drejtë kolektive e as lineare siç kërkojnë 200 magjistrat e mjekësisë. Çfarëdo vendimi që do të merrej do të ishte shkelje e Statutit të UP-së, të miratuar në Kuvendin e Kosovës.

Plotësisht e mbështeti përmbajtjen e peticionit të shkruar nga Komisioni për të drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore ku shkruan “se arbitrarisht janë ndërprerë studimet e më se 100 doktoratave të shkencave mjekësore që nga viti 2005, me vendim të Senatit dhe viti akademik i doktoratës për 80 kandidatë të zgjedhur me konkurs publik”.

Në vazhdim theksoi, se në rast se doktorantët vlerësojnë se u është bërë padrejtësi atëherë duhet të ndryshohet Ligji i cili është në fuqi.

Bahri Hyseni – krytar i komisionit për Legjislacion - tha se Komisioni me datën 2 mars 2009, ka shqyrtuar kërkesën e 135 magjistrave të shkencave mjekësore, të 80 doktorantëve legal të vitit 2005/06 dhe të provuarve të rinjtë për shkollim të doktoratës sipas konkursit të 19 janar 2009, para Komisionit paraqiti këto çështje:

Ai konstatoi, se duhet të gjendet zgjidhja e 135 magjistrave të shkencave mjekësore, të cilëve nuk ju është lejuar doktoratura, të cilët për shkollim i mbron Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Ai tha, se nuk duhet të bazohemi në konkursin publik të vitit 2005 nga FM për 80 kandidatët të zgjedhur, sepse tani konkursi është i paligjshëm pasi Statuti i UP-së është në fuqi.

Në fund diskutoi, se duhet të rishikohet konkursi i shpallur nga Universiteti i Prishtinës me 19 janarit 2009, për studimet e doktoratës sipas sistemit të Bolonjës në FM, me ç'rast nuk janë ftuar të gjithë kandidatët në testim për seleksionim në gjuhën angleze.

Ai theksoi se pas shqyrtimit nga ana e Komisionit funksional për Arsim, duhet të dalim me një Rekomandim unik i bazuar në shpalljen publike të vitit 2009, që kandidatëve t'ju sigurohet se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi. Çfarëdo vendimi tjetër që do të merret, do të jetë shkelje e Statutit të UP-së, të miratuar në Kuvendin e Kosovës.

Ai u pajtua me të gjitha propozimet të cilat i paraqiti rektori Hasani.

Mark Krasniqi – diskutoi se shoqëria jonë ka punuar që të respektohet ana shkencore, mirëpo nëse regjistrohen 200 apo 300 kandidatë në doktoratë atëherë si shoqëri do të dalim jo serioz.

Me vullnet të mirë duhet ti rishikojmë kërkesat e parashtruesve dhe më pastaj të marrim qëndrim që të bëhet ndryshimi i Ligjit.

Gani Buçinca - tha se presionin publik të cilin e kanë krijuar magjistrat e mjekësisë në procesin e regjistrimit në doktoraturë është rrugë e gabuar sepse zgjidhja duhet të gjendet në baza institucionale.

Ai diskutoi se te ne ka disproporcion në mes të gradës shkencore dhe dijes profesionale. Doktorantët duhet të kenë aktivitete dhe të ripërtërijnë punimet shkencore, ndërsa nëse për një periudhë të caktuar kohore nuk kanë punime të reja atëherë doktoratura duhet t'ju merret.

Njëherit nuk u pajtua me rektorin, se moshë mund të jetë pengesë për doktoraturë sepse sipas normave ndërkombëtare si çështje primare për doktoraturë është dija profesionale. Ai theksoi se për zgjidhjen e çështjes së magjistrave është që të rishikohet mundësia për procedurat e ndryshimit të Ligjit për Arsimin e Lartë apo Qeveria duhet të dalë me një vendim politik.

Heset Cakolli – duke pasur parasysh Statusin dhe Rregulloren e cila është dokumente bazë për rrjedhën e punës në Universitet ai theksoi se duhet të gjendet hapësirë ligjore për zgjedhjen e doktorantëve.

Ai kërkoi sqarim lidhur me paraqitjen e numrit të madh të studentëve që studimet e doktoratës ti vazhdojnë me sistem të vjetër, sepse në vitin 2005 kjo kategori e studentëve ishin të regjistruar. Sa është e arsyeshme që Statusi dhe Rregullorja të vlejë për një njësi e për tjerat të mos vlejë.

Adem Hajdari – tha se nuk duhet të bëjmë lëshime para këtij presioni se mund të krijohet një president i rrezikshëm për magjistrat e fakulteteve tjera.

Kërkoj sqarim lidhur me rastet, se pas ndjekjeve të studime posdiplomike ka arritur të magjistrojë ndërsa ka mbetur asistent. Propozoi që të gjendet bazë ligjore për tejkalimin e gjendjes së krijuar në Universitetin e Prishtinës.

Memli Krasniqi– tha se kërkesat të cilat i paraqesin magjistrat janë të arsyeshme, por ato mund të krijojnë precedent për drejtimet e tjera. Çështja e krijuar në Universitet duhet dhe kërkon zgjedhje të qëndrueshme e jo ad hoc.

E drejta për shkollim është e drejtë e garantuar, por gradat e magjistrave dhe doktorantëve nuk janë pjesë e arsimit obligativ. Ai shtoi se doktoratura është e drejtë individuale, ndërsa shtoi se duhet të rishikohen kriteret e konkursit të vitit 2009, por edhe çështja e konkursit të vitit 2005.

Sa i përket çështjes së përzgjedhjes, nuk duhet të diskriminohen kandidatët që nuk janë pjesë e stafit akademik të UP-së. Për këtë duhet të plotësohen tri kriteret: nota mesatare, njohja e gjuhës angleze dhe punimet shkencore, por duhet shikuar edhe mundësia që për përzgjedhje të vlerësohet edhe propozimi për hulumtim i kandidatit, ashtu siç bëhet në të gjitha vendet perëndimore. Nuk pajtohet me rektorin se mosha është kriter që të pengohet vazhdimi i doktoraturës. Njëkohësisht duhet të rishikohet Statuti, Rregullorja dhe të merren për bazë kriteret të cilat janë edhe në vendet në rajon, për sa i përket periudhës së tranzicionit nga sistemi i vjetër në sistemin e ri.

Drita Kadriu- kërkoj njohuri lidhur me fazën kalimtare dhe sa ka ndikuar kjo fazë kalimtare e sistemit të Boljonjës në vendin tonë, që të jenë më të lehta pasojat për kandidatët e interesuar për vazhdimin e studimeve të larta.

Agim Veliu – kryetar – konstatoi se ne duhet të mbështetemi vetëm në atë se a është shkelur Ligji dhe Statusi të cilat janë të miratuara në Kuvend, ndërsa në çështjet akademike nuk do të ndalemi fare pasi kjo çështje i takon Universitetit.

Ai vlerësoi se nëse konstatohen lëshime të ndryshme mbi baza ligjore, sidomos kur është fjala për konkursin për studimet posdiplomike të 19 janarit 2009, atëherë kandidatët e diskriminuar mund t'iu drejtohen organeve të drejtësisë.

Komisioni do të shqyrtoj si po zbatohet Ligji për Arsimin e Lartë dhe Statuti i UP-së dhe më pas do të marrë qëndrim se a duhet të fillojë procedura për plotësim dhe ndryshim të Ligji.

Komisioni konstatoi, se në bazë të konsultimeve me Komisionin për Legjislacion dhe atë për të Drejtat e Njeriut dhe Peticion, ku janë shqyrtuar të njëjtat kërkesa, në mbledhjen e ardhshme do të nxjerr një Rekomandim.

Mbledhja përfundoi në orën 12,50.

Kryetari i Komisionit

Agim Veliu